



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 83, DATË, 05.12.2024

“PËR MIRATIMIN E AMENDIMIT TË MARRVESHJES MIDIS BASHKISË GJIROKASTËR DHE FEDERATËS SHQIPTARE TË FUTBOLLIT”.

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 05.12.2024 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur “Për miratimin e amendimit të marrveshjes midis Bashkisë Gjirokastrë dhe Federatës Shqiptare të Futbollit”. Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr 09, datë 23.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ligjit 79/2017 “Për sportin” indryshuar, VKB nr 113, datë 14.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetit vjetor 2024”.

VENDOSI:

1. Të miratojë lidhjen e amendimit të marrveshjes midis Bashkisë Gjirokastrë dhe Federatës Shqiptare të Futbollit, sipas kushteve të përcaktuara në dokumentit bashkëngjitur.
2. Miratimin e burimit të financimit për vitin 2024 të projektit sipas kushteve të përcaktuara në amendimin e marrveshjes nga projekti P813AAB.
3. Miratimin e burimit të financimit për koston e shpronësimit nga projekti P813AAB.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Merita Isaraj



Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo